



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	25-7400
Nr./faqeve Br.stranica No.pages	-17-
Date: Datum: Date:	16.11.2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 188.XI.2023

Datë: 15.11.2023

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës , nxjerrë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Plani i veprimit për funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren (2023 - 2025).
- II. Shtojcë e vendimit është Plani i veprimit për funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren (2023 - 2025).
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Arben Viti
Ministër i Shëndetësisë

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Departamenti ZhSSH;
- Arkivit të MSh-së;



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

**Plani i veprimit për funksionalizimin e
Kardiologjisë Invazive në Spitalin e
Përgjithshëm në Prizren
(2023 - 2025)**

Prishtinë, Tetor 2023

Përmbajtja

1.	PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	4
2.	HYRJE	5
3.	METODOLOGJIA	7
4.	SFONDI.....	8
5.	OBJEKTIVAT	8
6.	ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	11
7.	NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISE.....	12

Shkurtesat

EKG	Elektrokardiogram
EVM	Edukimi Vazhdueshëm Mjekësor
IAM	Infarktiti Akut të Miokardit
KASh	Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve
KSV/017	Programi përkrahës i shëndetësisë në Kosovë - faza II
Lux Dev	Luxembourg Agency for Development Cooperation (Agjencioni për bashkpunim zhvillimi e Qeverisë së Luksemburgut)
MSH	Ministria e Shëndetësisë
Nr	Numër
PCI	Ndërhyrjet koronare perkutane
PSO	Procedura Standarde Operative
PV	Plani Veprimit
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
SKV	Sëmundjet kardiovaskulare
SP	Spitali i Përgjithshëm
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
UA	Udhëzimi administrativ
UA	Udhëzim Administrativ
ZhVP	Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

1. PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ministria e Shëndetësisë (MSH) me qëllim të përmirësimit të shëndetit të popullatës, ka iniciuar reforma thelbësore të sistemit ekzistues shëndetësor, me qëllim të zvogëlimit të sëmundshmërisë, barrën e sëmundjeve kardiovaskulare dhe vdekshmërisë, për të gjithë qytetarët e vendit.

Meqenëse Sëmundjet kardiovaskulare (SKV) janë shkaku kryesor i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, MSH në bashkpunim me partnerët strategjik (Qeveria e Luksemburgut) është duke investuar në funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren.

Numri i procedurave invazive kardiake do të rriten bazuar në infrastrukturën e kompletuar dhe praktike për punë, rritjes të numrit të kardiologëve intervent, infermierëve dhe stafit mbështetës, si dhe orarit të ri, përkatësisht me ofrimin e shërbimit të pandërprerë (24/7).

Trajtimi i duhur SKV do të ulë sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë, do të përmirësohet cilësia e jetës së pacientëve dhe familjeve të tyre. Barra e SKV do të ulët në të gjithë përcaktuesit nga ato ekonomike deri në ato sociale.

2. HYRJJE

Sëmundjet kardiovaskulare (SKV) janë shkaku kryesor i vdekjeve në botë. Nga 12.3 milion (25.8%) vdekje në 1990, vdekjet nga SKV arritën në 17.9 milion (31.0%) në vitin 2016. Nga këto vdekje, 85% janë për shkak të sulmit në zemër dhe goditjes në tru. Vdekjet, në moshë të caktuar, nga SKV janë në rritje në vendet në zhvillim.

Në Kosovë, arsyeja kryesore e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë të qytetarëve mbi 50 vjeç janë SKV. Në dekadën e fundit, ekziston tendencë e rritjes së sëmundshmërisë të madhë në moshë të reja dhe të vdekshmërisë për shkak të SKV. Bazuar në të dhënat epidemiologjike kombëtare, ekziston nevojë e arsyeshme për krijimin e programi kombëtar për trajtimin e SKV. Përqindja e popullatës së Kosovës me tre ose më shumë faktorë të rrezikut për SKV te grup moshat 18-44 vjet është gjithsej 21.2% (te meshkujt 26.4%, femrat 31.3%) ndërsa tek grup moshë 45-69 vjet është gjithsej 66.5% (meshkujt 64.7% dhe femrat 62.9%). Përqindja e popullatës me tre ose më shumë faktorë rreziku për SKV në total është 34.4% (meshkujt 37.3%, femrat me 40.0%) (Ref. STEPs Fact sheet-Departamenti i SISH, 2019).

Që nga viti 2018, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) rriti vëllimin e procedurave invazive, kryesisht të koronarografive dhe ndërhyrjet koronare perkutane (PCI). Gjatë vitit 2018 janë realizuar 2517 koronarografi dhe 1390 PCI, ndërsa në vitin 2022 janë realizuar 2929 koronarografi dhe 1730 PCI. Duke qenë se numri i gjithëmbarsëm i të sëmuarve në ditën e sotme është ekstremisht më i lartë, ku janë realizuar 2771 koronarografi dhe 1925 PCI (rreth 4700 raste të trajtuara në periudhën janar – shtator 2023) dhe në të njëjtën kohë kemi vetëm një institucion ku bëhen intervenimet e tilla, lind nevoja urgjente për të funksionalizuar edhe qendra të tjera, e në rastin konkret në Spitalin e Përgjithshëm (SP) në Prizren. Referuar Shoqatës Europiane të Kardiologjisë, në 200.000 banorë duhet të ekzistoj një sallë e kateterizimit.

Bazuar në rekomandimin e Shoqatës Europiane të Kardiologjisë dhe shtrirjes gjeografike dhe numrit të banorëve që ka Kosova, e në rastin aktual siç është Rrafshi i Dukagjinit, me prioritet duhet të funksionalizohet Kardiologjia Invazive në SP Prizren, pasi që ka mbulueshmëri regjionale duke mos harruar dhe pjesën veriore të Republikës së Shqipërisë, gjë që plotëson, madje dhe tejkalon numrin e referuar nga Shoqata Europiane e Kardiologjisë.

Funksionalizimi i kardiologjisë invazive në SP Prizren është me rëndësi jetike për popullatën e këtyre regjioneve, **prania e infrastrukturës rrugore moderne**, shkurtimi i kohës së transportit (përfitim më i madh është në kohë, gjithnjë duke u bazuar në standardin e artë që **KOHA** është **MUSKUL**) dhe shkurtimi i kohës në listen e pritjes në QKUK.

Të gjitha këto elemente të lartpërmendura janë indikatorë që SP i Prizrenit mund të plotësoj kërkesat për diagnostikim (koronarografia) dhe trajtim sëmundjeve iskemike të zemrës.

Gjatë hartimit të Planit të Veprimt (PV), u konsultuan edhe dokumente të tjera përkatëse, si: Ligji 04/L-125 për shëndetësi, Plani Kombëtar për Zhvillim 2030, Draft Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2023-2030, Plani Zhvillimor Zhvillimor Institucional i SP Prizren - 2022-2026, UA - Nr. 06-2015 Kushtet e përgjithëshme dhe të veçanta spitalore.

Zbatimi i PV kontribuonë në rritjen dhe promovimin e cilësisë, efektivitetit dhe sigurisë së ofrimit të shërbimeve, me qëllim ulje të shkallës së sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë nga SKV.

Sigurimi i trajtimit me kohë të Infarktut Akut të Miokardit (IAM) mundëson zvogëlimin e morbiditetin dhe vdekshmërisën e pacientëve, duke i mundësuar qytetarët të jetojnë jetë më të

gjatë dhe më cilësore. Sigurimi i këtyre shërbimeve në kohë dhe afër vendbanimit të tyre, është qasje më e drejtë dhe efektive e trajtimit për popullatën e Kosovës.

Andaj, funksionalizimi i Kardiologjisë invazive në SP Prizren do të ndikon pozitivisht në shëndetin afatgjatë të popullatës së Kosovës.

3. METODOLOGJIA

Plani i Veprimit për funksionalizimin e Kardiologjisë invazive në SP Prizren është hartuar duke u bazuar në metodologjinë e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ (UA) (QRK) 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Plani është hartuar nga grupi punues i emëruar me Vendim nga Sekretari i Përgjithshëm i MSH, me nr. protokollit 05-6219 të datës 05.10.2023.

Për përgatitjen e planit janë shqyrtuar të dhëna të bazuara në dëshmi nga Klinika Kardiologjike në QKUK dhe SP Prizren.

Analiza e gjendjes të SKV në Kosovë, duke përdorur standardet ndërkombëtare është kryer. Analizat u përqendruan në sëmundshmërinë, vdekshmërinë, qasjen, pajisjet dhe stafin për intervenime koronare. Rezultatet e analizave të gjendjes paraqitën bazën për fillimin e funksionalizimit të Kardiologjisë Invazive në SP Prizren.

Janë realizuar takimet e rregullta të grupit punues në bashkpunim me partnerët ndërkombëtarë (KSV / 017) dhe janë diskutuar të gjitha aspektet dhe nevojat për funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive në SP Prizren.

Drafti final i Planit të Veprimit i dorëzohet MSH për miratim.

"Programi i Mbështetjes së Shëndetit në Kosovë - Faza II - KSV / 017" siguron mbështetjen e vazhdueshme përmes ekspertizës ndërkombëtare dhe kombëtare për programin që nga faza e fillimit të tij.

4. SFONDI

Sëmundjet Kardiovaskulare janë shkaku kryesor i vdekjes në nivel global. Janë shkaktarë të 17.9 milion vdekjeve (31.5%) në vitin 2019. Vdekjet, në një moshë të caktuar, nga SKV janë në rritje në vendet në zhvillim.

Përqindja e popullatës së Kosovës me tre ose më shumë faktorë të rrezikut për SKV te grup moshat 18-44 vjet është gjithsej 21.2% (te meshkujt 26.4%, femrat 31.3%), ndërsa te grup moshë 45-69 vjet është gjithsej 66.5% (meshkujt 64.7% dhe femrat 62.9%). Përqindja e popullatës me tre ose më shumë faktorë rreziku për SKV në total është 34.4% (meshkujt 37.3%, femrat me 40.0%).

Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Shërbimi i Kardiologjisë Invazive është i vetmi institucion publik në vend që ofron shërbime të kardiologjisë intervente.

Duke ditur rëndësinë e sigurimit të intervencës koronare, për të zvogëluar vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë e SKV, MSH vendosi të inicioj funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive në SP Prizren për trajtimin e SKV.

Të dhënat e SP Prizren për vitin 2022, tregojnë se në spital funksionon njësinë intensive dhe njësi koronare në kuadër të repartit të sëmundjeve të brendshme. Punojnë 6 kardiologë dhe 15 infermierë në kapacitet prej 11 shtretër aktualisht. Me funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive do të shtohen edhe 5 shtretër.

Me qëllim të funksionalizimit të Kardiologjisë Invazive në SP Prizren është bërë planifikimi i burimeve njerzore i cili duhet miratuar nga MSH dhe SHSKUK:

- Udhëheqësi i laboratorit të kateterizimit (fillimisht nga QKUK);
- Udhëheqësi i ekipit ditor;
- Kryeinfermieri;
- 1 administrator;
- 2 kardiolog intervent;
- 3 infermierë për sallë;
- 8 infermierë për repartin post-koronar;
- 4 higjienistë.

Me qëllim të funksionalizimit të Kardiologjisë Invazive në SP Prizren duhet të sigurohet që SP Prizren në bashkëpunim me MSH, QKUK, Odat e Profesionistëve Shëndetësor, të ketë:

- Kardiologë të trajnuar dhe të kualifikuar në procedurat e kardiologjisë invazive. Në vazhdimësi të ndjekën trajnime në kardiologjinë invazive.
- Infermierë të trajnuar në teknikat specifike infermiore të kateterizimit. Në vazhdimësi të ndjekën trajnime në kardiologjinë invazive.
- Stafin administrativ për të menaxhuar planifikimin, të dhënat e pacientëve dhe faturimin.
- Stafin e mirëmbajtjes për pastërtinë e Kardiologjisë Invazive.

Me qëllim të zbatimit të suksesshëm të shërbimeve në Kardiologjinë Invazive në SP Prizren, propozohet modaliteti:

1) Funksionalizimi i pjesërishëm i aktiviteteve në 24/2.

Realizimi i intervenimeve në Kardiologjinë Invazive në SP Prizren, sipas përlllogaritjes të bërë në raport me burimet njerzore/shtretërit/kohën (orarin), brenda një jave:

- me orarin e punës 24 orësh mund të kryhen:
 - 2 herë në javë x 5 raste elektive/ditë = 10 pacientë të trajtuar.
 - 52 javë x 10 raste elektive/ditë = 520 pacientë të trajtuar brenda vitit.

*** Kjo përlllogaritje nuk përfshinë numrin e rasteve me IAM.**

Bazuar në numrin e shtretërve që disponon njësia koronare (5 shtretër) dhe laboratorit i kateterizimit (5 shtretër), nënkupton që SP Prizren ka kapacitet të akomodoj maksimum 5 pacientë brenda 24 orëve. Duke marrë parasysh që pacientërt duhet trajtuar rreth 24 - 48 orë, nënkupton që shfryzutmshëria e shtretërve të disponueshëm në spital do të jetë 100%.

Me qëllim të funksionalizimit të Kardiologjisë Invazive në SP Prizren, SHSKUK duhet të siguroj materialin/pajisjet mjekësore shpenzuese bazuar në UA - Nr. 06-2015 Kushtet e përgjithëshme dhe të veçanta spitalore. Po ashtu duhet të sigurohet servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e të gjitha pajisjeve mjekësore nga operatorët ekonomik të licencuar.

SP Prizren duhet të bazohet dhe të zbatoj Udhërrëfyesit Klinik dhe Protokolet Klinike konform Udhëzimit Administrativ në fuqi.

Me qëllim të funksionalizimit të Kardiologjisë Invazive në SP Prizren, SHSKUK obligohet të siguroj:

- burimet njerëzore si mbështetje ndaj SP në Prizren dhe të siguroj kodet e nevojshme për punësimin e tyre,
- stimulimin financiar shtesë për të gjithë punonjësit që do të ofrojnë shërbimet profesionale,
- mjetet e nevojshme për mirëmbajtjen e rregullt të angiografit si dhe pajisjeve përcjellëse.

5. OBJEKTIVAT

Plani i Veprimit për funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive në SP Prizren në sistemin e kujdesit shëndetësor të Kosovës në vitin 2023, synohet të zbatohet përmes:

Objektivi strategjik

- Funksionalizimi i Kardiologjisë Invazive në SP Prizren për qytetarët e regjionit të Prizrenit dhe më gjerë.

Objektiva specifike

- Ofrimi i shërbimeve profesionale në Laboratorin të kateterizimit në SP Prizren

Këto objektiva synohen të zbatohen përmes aktiviteteve si në vijim:

- Vlerësimi i hapsirave ekzistuese mbrenda dhe jashtë objektit në Kardiologjinë Invazive në SP Prizren;
- Vlerësimi i pajisjeve ekzistuese;
- Sigurimi i pajisjeve shtesë të nevojshme;
- Sigurimi i stafit të specializuar për ofrimin e shërbimit;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe Edukimi i Vazhdueshëm Mjekësor;
- Ofrimi i shërbimeve shtesë;
- Mirëmbajtja e pajisjeve.

6. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Realizimi i aktiviteteve për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Veprimit për funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive në SP Prizren, do të mundësojnë sigurimin e të dhënave të bazuara në dëshmi lidhur me arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë dokument. Qëllimi i monitorimit është ofrimi i raporteve lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit, sipas të dhënave zyrtare, të cilat do të shërbejnë për vendime të bazuara në dëshmi për MSH-në.

Bazuar në indikatorët kyç të definuar në Plan të Veprimit, monitoron indikatorët sipas periudhës dhe frekuencës së përcaktuar dhe raporton në MSH duke siguruar që institucionet dhe departamentet përgjegjëse të ofrojnë llogaridhënie në rast të moszbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të planifikuara.

Ky proces do të ndikoj në ndryshimin dhe plotësimin vjetor të Planit të Veprimit. Parim udhëheqës gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit është gjithëpërfshirja, ku në proces të monitorimit dhe vlerësimit do të përfshihen të gjithë akterët dhe institucionet hisedare në këtë fushë përmes shfrytëzimit të kapaciteteve institucionale, procedurave të brendshme dhe mekanizmave tjerë administrativë që lidhin dhe mundësojnë komunikimin e institucioneve shëndetësore mes vete. Në këtë proces, theksi është vënë në përdorimin e mekanizmave ekzistues për mbledhjen, agregimin, analizën dhe diseminimin e të dhënave në kuadër të Ministrisë dhe institucioneve tjera të përfshira. Ky dokument përfshin një numër të indikatorëve në nivele të ndryshme të zbatimit për periudhën kohore të përcaktuar në dokument, duke shfrytëzuar burime të informatave, raportime në periudha të rregullta përmes strukturave të përcaktuara të procesit të monitorimit.

Raportimi i zbatimit të aktiviteteve, sfidave eventuale dhe rekomandimet për ndryshime, do të jenë periodike dhe me kohë. Kjo do të mundësojë adresimin në kohën e duhur nga gjetjet e raporteve, për qëllim orientimin e politikave për shërbimet e ofruara në Kardiologjinë Invazive në SP Prizren.

Rezultatet e pritura nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të mundësojnë edhe ofrimin e informatave kthyes efektive dhe me kohë për të gjitha grupet e interesit, ofrimin e raporteve të performancës së tyre, raportet fillestare ku janë të përcaktuara vlerat bazë të treguesve krahasuar me vlerat e pritshme dhe të dëshirueshme, raportet periodike të progresit si dhe raportet vjetore të performancës.

Vlerësimi përfundimtar i dokumentit do të ofroj të dhëna të bazuara në dëshmi të cilat do të shfrytëzohen si bazë për përcaktimin e kahjeve strategjike në periudhat e ardhshme si dhe hartimin e dokumenteve tjera në vazhdimësi. Raportimi i monitorimit të progresit, zbatimit dhe arritjeve të Planit të Veprimit do t'i prezantohet të gjitha institucioneve hisedare si dhe instancave përkatëse në baza të rregullta dhe kur është e nevojshme edhe publikut.

7. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Zbatimi i Planit të Veprimit për funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive në SP Prizren, paraqet sfidë institucionale për sektorin e shëndetësisë dhe të gjitha palët e përfshira, marrë parasysh burimet njerëzore në dispozicion si dhe burimet financiare. Megjithatë, MSH/SHSKUK në bashkëpunim me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit për arritjen e objektivave, do të angazhohet dhe do të zbatojë një kombinim masash që përfshijnë përmirësimin e politikave dhe standardeve profesionale, promovimin dhe edukimin shëndetësor si mekanizëm për avancimin e shëndetit të qytetarëve në regjionin e Prizrenit dhe më gjerë, ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësor për intervenimet e bazuara në evidencë, sigurimin e kushteve infrastrukturore dhe pajisjeve në Kardiologjinë Invazive në SP Prizren.

Referuar Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025 (KASh 2023-2025), SHSKUK obligohet që të paraqes dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2024.

PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit për funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive në SP Prizren								
Objektiva strategjike: Funksionalizimi i Kardiologjisë Invazive në SP Prizren për qytetarët e regjionit të Prizrenit dhe më gjerë								
Objektiva specifike 1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza 2023	Caku 2024	Caku 2025				
Ofrimi i shërbimeve profesionale në Laboratorin të kateterizimit në SP Prizren	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i hapsirave ekzistuese mbrenda dhe jashtë objektit në Kardiologjinë Invazive në SP Prizren; - Vlerësimi i pajisjeve ekzistuese; - Sigurimi i pajisjeve shtesë të nevojshme; - Sigurimi i stafit të specializuar për ofrimin e shërbimit; - Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe Edukimi i Vazhdueshëm Mjekësor; - Ofrimi i shërbimeve shtesë; - Mirëmbajtja e pajisjeve. 	%	%	%				
Aktiviteti 1 (Hapsira & Pajisjet)	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2023	2024	2025				
1.1 Ndërtimi i hapsirës për Kardiologjinë Invazive me të gjitha parametrat dhe standardet ndërkombëtare arkitekturore dhe mjekësore	K - IV 2023	993,574. 85€	0.00€	0.00€	MSh SHSKUK	SP Prizren	MSH SHSKUK	Finalizimi i hapsirës me rreth 500 m ²
1.2 Mirëmbajtja e hapsirës (klimatizimi, ventilimi, USB, nyjet sanitare, ngjyrosja, sistemi i gazrave dhe elektrika)	2024 - 2025	0.00€	30,000.0 0€	50,000.0 0€	MSh SHSKUK	SP Prizren	MSH SHSKUK	Mirëmbajtje e vazhdueshme
1.3 Pajisjet për funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive (Aparati i koronarografisë;	K - IV 2023	1,450,00 0.00€	0.00€	0.00€	Lux Dev	SP Prizren	MSH SHSKUK Lux Dev	Angiorafi Philips i montuar me mjetet

ultratingulli; defibrilator, monitor, EKG, aspirator, perfusion, ultratingull portabël, etj.)								përcjellëse, kryesore dhe ndihmëse.
1.4 Mjetet për diagnostikim dhe mjekim (kateteret, stentat, si dhe mjetet tjera përcjellëse medikamentose, etj.)	K - IV 2023	0.00€	500,000.00€	1,000,000.00€	SHSKUK	SP Prizren	MSH SHSKUK Donatorët	Të gjitha mjetet ekzistuese në dispozicion
1.5 Materiali shpenzues (seti steril për personel dhe pacient, doreza, etj.)	K - IV	0.00€	50,000.00€	100,000.00€	SHSKUK	SP Prizren	MSH SHSKUK Donatorët	I gjithë materiali shpenzues në dispozicion
1.6 Veshjet kundër rrezatimit (jelek, fund, qafore, syze nga 10 copë dhe 2 varëse mobile)	K - IV	17,000.00€	17,000.00€	17,000.00€	SHSKUK Lux Dev	SP Prizren	MSH SHSKUK Donatorët	Veshjet kundër rrezatimit në dispozicion
1.7 Inventari jo medicinal (tavolina pune, karriga, dollapë, etj.)	K - IV	50,000.00€	5,000.00€	5,000.00€	SHSKUK Lux Dev	SP Prizren	MSH SHSKUK Donatorët	Inventari jo medicinal në dispozicion
1.8 Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e të gjitha pajisjeve mjekësore nga operatorët ekonomik të licencuar (10% e vlerës së produktit)	2023 - 2025	0.00€	0.00€	0.00€	Lux Dev	SP Prizren	MSH SHSKUK Donatorët	Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt në vazhdimësi nga Operatori Ekonomik i licencuar
Aktiviteti 2 (Burimet njerëzore)	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2023	2024	2025				
2.1 Udhëheqësi i laboratorit të kateterizimit (fillimisht nga QKUK)	2023 - 2025	0.00€	15,750.00€	15,750.00€	SHSKUK	SP Prizren	MSH	1 udhëheqës kardiolog

2.2 Udhëheqësi i ekipit ditor	2023 - 2025	0.00€	15,120.0 0€	15,120.0 0€	SHSKUK	SP Prizren	MSH	1 udhëheqës Kardiolog
2.3 Kryeinfermier (fillimisht nga QKUK)	2023 - 2025	0.00€	7,938.00 €	7,938.00 €	SHSKUK	SP Prizren	MSH	1 kryeinfermier
2.4 Kardiolog Intervent	2023 - 2025	0.00€	15,120.0 0€	15,120.0 0€	SHSKUK	SP Prizren	MSH	2 kardiolog
2.5 Administrator	2023 - 2025	0.00€	7,182.00 €	7,182.00 €	SHSKUK	SP Prizren	MSH	1 administrator
2.6 Infermierë për sallë	2023 - 2025	0.00€	6,930.00 €	6,930.00 €	SHSKUK	SP Prizren	MSH	3 infermierë për sallë
2.7 Infermierë për repartin post-koronar	2023 - 2025	0.00€	6,930.00 €	6,930.00 €	SHSKUK	SP Prizren	MSH	8 infermierë për repartin post-koronar
2.8 Higjienistë	2023 - 2025	0.00€	4,788.00 €	4,788.00 €	SHSKUK	SP Prizren	MSH	4 higjienistë
Aktiviteti 3 (ZHVP & EVM)	Afati i zbatimit		Kostoja totale		Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
3.1 Trajnimi i vazhdueshëm Kardiologëve në procedurat e kardiologjisë	2024 - 2025	0.00€	50,000.0 0€	50,000.0 0€	SHSKUK SP Prizren Odat Donatorët	SHSKUK SP Prizren	MSH Odat Donatorët	3 kardiolog të trajnuar (nga 3 muaj)
3.2 Trajnimi i infermierëve të kardiologjisë në teknikat specifike të kateterizimit si dhe në trajnimet tjera	2024 - 2025	0.00€	30,000.0 0€	30,000.0 0€	SHSKUK SP Prizren Odat Donatorët	SHSKUK SP Prizren	MSH Odat Donatorët	12 infermier të trajnuar (nga 3 muaj në QKUK dhe/ose 1 muaj jashtë vendit)
3.3 Pjesëmarrja në konferenca/simpoziume/kongrese/puntori	2024 - 2025	0.00€	15,000.0 0€	15,000.0 0€	SHSKUK SP Prizren Odat Donatorët	SHSKUK SP Prizren	MSH Odat Donatorët	3 kardiologë dhe 12 infermier

3.4 Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mbështetës në kardiologji	2024 - 2025	0.00€	5,000.00 €	5,000.00 €	SHSKUK SP Prizren Donatorët	SHSKUK SP Prizren	MSH Odat Donatorët	5 persona të trajnuar
3.5 Adaptimi / Hartimi i Udhërrëfyesve Klinik dhe Protokolleve Klinike, përfshirë monitorimin e zbatimit	2024 - 2025	0.00€	15,000.0 0€	15,000.0 0€	MSH Donatorët	SHSKUK SP Prizren	MSH Odat Donatorët	Udhërrëfyesi Klinik dhe Protokolle Klinike të hartuar.
3.6 Hartimi dhe monitorimi i zbatimit i PSO-së	2024 - 2025	15,000.0 0€	15,000.0 0€	0.00€	MSH Donatorët	SHSKUK SP Prizren	MSH Odat Donatorët	PSO e hartuar.
Total:		2,525,57 4.85 €	765,768. 00 €	1,320,76 8.00 €				
		4,612,110.85 €						